

## **RAPORT TOPOGRAFIK**

**Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës “ARKITEKT KASËMI”**

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Pershkrimi i zonës ku do te implementohet projekti</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Punimet topografike ne terren</b>	<b>4</b>
2.1	Sistemi i Referimit dhe Metodologjia e punës.....	4
2.2	Ndërtimi i stacioneve mbështetëse .....	6
2.3	Rilevimi përfundimtar dhe pikat e rilevuara me koordinata.....	Error!

Bookmark not defined.

## Hyrje

Ky raport përshkruan punimet topografike të kryera për hartimin e projektit të zbatimit të objektit: Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës “ARKITEKT KASËMI”.

Punimet topografike të zonës shtrihen nga Kryqezimi pranë Bashkise (Rr. Sadush Myftari) (40°30'15.6N 20°13'29.8E) dhe vazhdojnë në drejtimin e rrugës “Arkitekt Kasemi” (40°30'37.9N 20°13'41.0E). Elementet kryesore të rëluara dhe të përcaktuara në pozicion janë:

- Rilevimi topografik i gjendjes ekzistuese të rruges.
- Rilevimi topografik i gjendjes së trotuareve.
- Rilevimi topografik i trotuareve ekzistuese.
- Rilevimi topografik i rrjetit inxhinierik ekzistues.
- Rilevimi i urës metalike kryqëzimi i rrugës Tefik Rogu.
- Ndërtimi i modelit dixhital të terrenit.
- Rilevimi i detajuar i terrenit dhe identifikimi i elementeve të tij.
- Rilevimi i të gjithë elementeve përbërës të zonës ku do implementohet projekti.

## **1 PERSHKRIMI I ZONËS KU DO TË IMPLEMENTOHET PROJEKTI**

Ky projekt lokalizohet në bashkinë Skrapar nga Kryqezimi pranë Bashkise (Rr. Sadush Myftari) dhe vazhdojnë në drejtimin e rrugës “Arkitekt Kasemi”. Zona ku ky projekt shtrihet është zona në Shqipërinë e Jugut me koordinata gjeografike 40°30'15.6N 20°13'29.8E dhe 40°30'37.9N 20°13'41.0E, e karakterizuar nga zone urbane me biznese në të dyja anët e rrugës ku kalon projekti.

Implementimi i projektit parashikon ndërtimin e trotuareve, rigjenerimin e rrjetit të ndriçimit rrugor, riparimin e bordurave dhe rivitalizimin urban të zonës.

## 2 PUNIMET TOPOGRAFIKE NE TERREN

### 2.1 SISTEMI I REFERIMIT DHE METODOLOGJIA E PUNËS

Për kryerjen e këtij rievimi është përcaktuar që të përdoret Sistemi UTM (Universal Transversal Mercator) bazohet në sistemin global WGS84.

Si stacione referuese janë marre stacionet e sistemit ALBCORS duke përdorur marres GNSS Topcon Hiper V. Fillimisht është bërë matja e stacioneve referuese dhe me pas është punuar me marres GNSS dhe me Dron për kryerjen e punimeve të tjera rievuese të nevojshme.

Pajisjet topografike të përdorura janë Topcon Hiper V si GNSS, Stacion Total Robotik Leica TCRP1200 dhe Dron DJI Phantom 4 RTK.



Puna është kryer përgjithësisht me marres GNSS nëpërmjet sistemin RTK duke përdorur një marres si baze dhe dy marres Rover. Përdorimi i Stacionit total është bërë vetëm në zonat ku mundësia e matjeve me GNSS ishte e vështirë. Për përdorimin e stacioneve të referimit (pikave të forta) është bërë me baza të vendosura mbi trekëmbështa.

Një rievim i plote i gjurmës së projektit është bërë me Dron topografik duke përdorur sistemin RTK për pajisje Aerofotografike. Qëllimi i përdorimit të dronit është për një mbulim të plote të zonës por edhe për prodhimin e imazheve dhe pikave fotogrametrike duke përmirësuar cilësinë dhe saktësinë e rievimit.



## **2.2 NDËRTIMI I STACIONEVE MBËSHTETËSE**

Stacionet mbështetëse të zonës janë shpërndarë në terren gjatë gjithë gjatësisë së objektit për të siguruar mbulim dhe sinjal në të gjithë zonën e projektit. Vendosja e stacioneve të reja është bërë me shufra metalike ose gozhde të vendosura në pozicione statike të pa levizshme.


Matjet e pikave të forta janë bërë me metodën statike duke qëndruar mbi stacion 10 minuta për të marrë një numër optimal matjesh në përcaktimin e stacioneve të referimit. Gjatë përcaktimit të pozicionit me të përshtatshëm të pikave janë zgjedhur me bazament të qëndrueshëm dhe të fortë për të mos pësuar deformim dhe gabim në matje.

Tolerancat maksimale të lejuara për rrjetin mbështetës është përcaktuar:

- Në plan  $\pm 25$  mm
- Në lartësi  $\pm 10$  mm

Gjatë punës në terren është bërë llogaritja e kohës së nevojshme të qëndrimit mbi pike, kostelacioni me të përshtatshëm të sateliteve, numri i matjeve në minute, etj.

Janë përcaktuar 5 stacione (Pika të Forta) për ndërtimin e rrjetit mbështetës.



PROJEKTUES  
“HTS COMPANY” SH.P.K